

Paraqitje e Shkurtë

Hermeneutika përcakton parimet dhe metodat e interpretimit. Prej pikpamjes hermeneutike, gjithçka mund të interpretohet si tekst: karikaturat, vizatimet, pikturat, fotografitë, filmat, tekstet fiktive e jo fiktive, e të tjera. Tipikisht, kritiku zgjedhë një teori, brenda të cilës ai ose ajo interpreton subjektin e tij. Për shembull, teoria feministe mund të dobisohet me interpretua një poemë, film, roman, tekst shkollor, etj.

Hermeneutika, si arti i interpretimit, qëndron përkrah disiplinave si folozofia e mendjes dhe filozofia e artit. Prandaj, ashtu si subjekti i filozofisë së artit është arti, edhe subjekti i hermeneutikës është interpretimi—i cili hulumtohet në kontekstin e qenjes njerzore si përdoruese e gjuhës, përjetuese e historisë, zhvilluese e artit dhe përvojave estetike, dhe praktikitetit të jetës.

Filozofët që njihen si formulues të hermeneutikës përfshijnë: Schleiermacherin, Diltheinin, Heideggerin, Gadamerin, dhe Paul Ricoeurin.

Në një vështrim më të përgjithshëm, hermeneutika është studimi i parimeve dhe metodave të interpretimit të subjekteve ku përfshihen qëllimet, bindjet, veprimet e njeriut, si edhe në disiplina si letërsia, fjalimet historike, simbolet historike, dhe gjithçka që mund të shqisohet ose konceptohet—*prej arkitekturës së Urës së Mesit deri te fjalimi i Mark Lulës¹, Flamurtarit të Shalës, në Lidhjen e Prizrenit; prej filmave pa zë të filmat e aksionit; prej rrëfimeve ku tregimi ngjitet prej komplotit, rrëfimeve ku tregimi ngjitet prej personazheve, te veprat ku tregimi shpëllon brenda një sistemi, prej karikaturave politike të pikturat klasike; prej teksteve të shkencave shoqërore të skripturave divine.*

a. Përvoja interpretative (kuptimi si interpretim)

Sipas hermeneutikës, kur thona se ‘kuptojmë diçka’ nënkuptojmë që interpretojmë diçka. Përspektazi, ku thona se nuk kuptojmë thona ‘nuk mund të interpretojmë’. Megjithëse eksperimentet dhe doktrinat mund t’i japin mbështetje interpretimit, dhe interpretimi ngrihet në baza të shëndosha epistemologjike, me interpretim kemi parasysh se jemi ne ata që kuptojmë diçka, jo interpretimin e diçkaje në varsi prej parimeve të një doktrine a eksperimenti. Është qenja menduese ajo që kupton diçka, pikrisht sepse ajo është menduese.

Interpretimi është edukativ sepse duke interpretua diçka, interpretuesi mund të mësojë rreth vetes, qenjve të tjera, a botës. Për shembull, kryengritësit e viteve 1911-1912, mësuan se jo të gjithë shqiptarët dëshironin shpërndarje shpirtore e kulturore prej pushuesit; patriotizmi e nacionalizmi janë koncepte të komplikuar. Kjo tregon se të kuptuomit e tyre ishte i paplotë. Hermeneutika e njëj paplotësinë jo vetëm në herë (Arb.)

¹ Sipas Gjergj Fishtës

të veçanta, por si një aspekt i interpretimit sepse ajo i njeh qenjes njerzore si meritat si kufizimet e saj.

1.2 Kundër Themeleve të Bindjes

Fraza 'kundër themeleve të bindjes' (en. against foundationalism) nuk cakton me kundërshtua ndonjë teori as nuk anon kah relativizmi. Por, të vërtetat duhen dallua si të nevojëshme ose kontingjente. Kur ndërtojmë argumente, te nevojëshmet i vendosim në themele, ndërsa kontingjentet mbë to. Kështu, struktura e argumentit merr formë vertikale. Ndërsa ditunia zhvillohet, njohuni të reja vëhen gomilë njëna-mbë tjetrën. Në teori, vertikalteti mund të ngrihet pafundsisht. Por, këtu ka një problem. Sikur të zbulohet që bindjet që qëndrojnë në bazë të kësaj strukture vertikale janë të pavërteta, atbotë e gjith ndërtesa e ditunisë do të shembej.

1.3 Cikli Hermeneutik

Në vend të vertikalizimit (shih më nël), hermeneutika bazohet në rrethsi (en. circularity), ku interpretimi bazohet në marrdhanjen në mes pjesëve me tansinë. Ky proces përkufizohet në dy hapa: 1) Æsht e nevojëshme me njohë tansinë në mënyrë që me njohë pjesët, dhe 2) Æsht e nevojëshme me njohë pjesët në mënyrë që me njohë tansinë. Kurdo që ka një interpretim të rí, ai bazohet në një kuptim të ndryshëm a më të thellë të marrdhanjes pjesë <> tansí.

Por, cikli nuk mbetet në vend; ndërsa interpretimi zhvillohet, dija depërton gjithnjë e më thellë në çashtje. Kjo pikpamje, Æsht krejt e ndryshëme prej pikpamjes vertikale, e cila me çdo shtim informacioni ngrihet nël.

thellsia vs. nãltsinë

Një çashtje tjetër këtu Æsht edhe reparimi i gabimeve. Në pikpamjen vertikale, kur gabimi ndodhë në themele, ndërtesa bjen. Kurse në pikpamjen rrethore, interpretimi lejon që gabimet të reparohen pa shkatërrua tansinë sepse marrdhanjet në mes tansisë e pjesëve nuk ka në bazë varsinë.

Në letërsí, mund të thohet se Æsht e nevojëshme me njohë të gjithë tekstin në mënyrë që me njohë më mirë personazhet, mjedisin, idetë, e të tjera. Po ashtu, Æsht e nevojëshme me njohë pjesët (personazhet, mjedisin, temat, etj.) në mënyrë që me njohë tansinë.

